



QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

R A P O R T V J E T O R

**Për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
për vitin 2020**

Janar, 2021

HYRJE

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është dokument bazik afatmesëm, i cili bazën e vet juridike e ka në Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal (nenet 12-14), i përgatitur me qëllim që të zvogëlohen disparitetet në mes rajoneve planore, si dhe në vetë rajonin, dhe të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm përmes shfrytëzimit të potencialeve të disponueshme të përgjithshme.

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetor kryhet përmes Planit aksionar realizimi i të cilit është bazë për realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor, përkatësisht në zhvillimin ekonomik, infrastrukturor, rural, turizëm dhe kulturë, si dhe ai arsimor dhe social dhe aspektet e tjera të zhvillimit të RPJP.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në pajtim me detyrimet ligjore, dhe duke i respektuar praktikatat e transparencës së punës, e përgatit këtë Raport Vjetor për realizimin e programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2020.

Në Raport, projektet dhe aktivitetet drejtpërdrejtë janë të ndërlidhura me Qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat nga Programi për zhvillim, si dhe me treguesit për shkallën e realizimit të këtij dokumenti bazik në vitin rrjedhës. Raporti vjetor është i konceptuar në katër pjesë me çka çdo pjesë përmban aktivitete të realizuara të projektit në pajtim me qëllimet afatmesme.

Në Raportin vjetor përveç pjesës narrative janë vendosur edhe detalisht edhe qëllimet afatmesme përkatëse, prioritetet, masat, treguesit dhe rezultatet dalëse, si dhe përmbledhja e tyre tabelore.

Vlen të theksohet se aktivitetet e prezantuara në pjesë më të madhe janë realizuar nga Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, por gjithashtu edhe nga ana e komunave në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor.

Pjesa më e madhe e aktivitetëve janë financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal, Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) bashkë me Ministrinë për vetëqeverisje lokale përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, Programit për zhvillim rural të Agjencionit për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe nga donatorë të jashtëm BE, UNDP dhe të tjerë.

Të gjithë aktorët bashkërisht kontribuojnë në realizimin e programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor dhe me atë japin kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e rajonit dhe përmirësimin e kushteve për jetesë të qytetarëve.

Qëllimi afatmesëm 1

Ekonomi moderne rajonale e bazuar në teknologji dhe njohuri të larta

1. Identifikimi dhe realizimi i projektit nga Strategjia për inovacione të RPJP

Në fillim të vitit 2020, përmes thirrjes interne të Agjencionit zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim (partner me Ministrinë për vetëqeverisje lokale në projektin “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”) deri te Qendrat për zhvillim u dorëzua thirrje për dorëzim të projekteve inovative. Me qëllim që të aplikohen projekte kualitative dhe të përpunohen aplikacione Qendra për zhvillim, organizoi dy punëtori planifikuese, me rreth 40 pjesëmarrës nga komunat, akademja, biznes sektori dhe OJQ. Pas mbarimit të procesit përgatitor u kalua kah përgatitja e këtyre projekt koncepteve: 1. “Eco Boat (eko varkë)”, 2. “Bujqësi e mençur” dhe 3. “Transport i mençur në RPJP përmes zhvillimit dhe realizimit të rrjetit të gjerë të ulët-energjetik IoT (LPWAN IoT) e bazuar në LoRe Wan teknologjinë (faza I)”. Në fazën e vlerësimit, nga ana e Komisionit i përbërë nga ana e përfaqësuesve të MVL dhe Agjencionit zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim, më mirë u vlerësua projekt ideja për zhvillimin e eko varkës, me çka si partnerë në projekt u paraqitën më shumë subjektenga biznes sektori dhe OJQ-të, Kapetania, si dhe Komunat e Strugës dhe Ohrit. Për projektin e përmendur u përgatiti aplikacioni i tërësishëm dhe i njëjti u dorëzua te Ministria e vetëqeverisjes lokale. Në dy raste të ndryshme, për çështje të ndryshme të lidhura me qëndrueshmërinë e projektit, me anëtarët e Komisionit për vlerësim të projekteve, u organizuan edhe takime zyrtare me përfaqësues të Qendrës dhe partnerët e projektit. Gjatë kësaj u theksua nevoja për sigurimin e dokumentacionit shtesë nga ana e partnerëve të projektit, përkatësisht nga Kapetania, Organizata joqeveritare Aqua Strugë dhe kompania Uniplast BK. Në afatin e dhënë, dokumentacioni shtesë i kërkuar nuk u dorëzua nga ana e partnerëve të projektit, me çka i njëjti nuk u pranua për realizim nga ana e MVL dhe SDC.

Masa 1.1.2 Rritja e kapaciteteve për inovacion të ndërmarrjeve nga Rajoni

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për rritjen e kapaciteteve për inovacion

Rezultatet dalëse

- Dy punëtori konsultative të organizuara me 40 pjesëmarrës nga rajoni
- 4 takime të organizuara me grupe punuese
- Të gjeneruara dhe të përgatitura 3 koncepte për projekte inovative
- Për konceptin e përzgjedhur u përgatit aplikimi i plotë dhe u dorëzua deri te donatori
- 2 takime të organizuara me partnerët e projektit

2. Përhrahje të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”

Në kuadër të projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, janë nënshkruar Marrëveshje për përkrahje financiare të Qendrës, për realizimin e Forumeve rajonale për projekte investuese për Shemën e granteve nga vitet 2019 dhe 2020, forume rajonale për propozim projekte rajonale me të cilat Qendra aplikoi tek Byroja për zhvillim rajonal për mjete nga Programi për ZHBR për vitin 2021, dhe përgatitjen e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën e ardhëshme pesë vjeçare.

2.a Organizimi i forumeve rajonale për identifikimin e projekt ideve për projekt investues për Shemën e granteve 2019

Në fillim të vitit 2019 u organizuan 3 forume rajonale për identifikimin e projekt ideve, nga ku doli projekti “Rregullimi i zonave dhe rrugicave atraktive në rajonin planor Jugperëndimor”. Ky projekt u realizua nga periudha maj 2019 deri në mars të vitit 2020. Në fund të muajit shtator 2020 u mbajt forumi i katërt rajonal në të cilin para pjesëmarrësve u prezantuan rezultatet e realizimit të këtij projekti kapital. Për shkak të situatës së krijuar me COVID 19 në takim morrën pjesë vetëm 25 persona, përfaqësues të palëve të interesuara nga rajoni planor Jugperëndimor.

2.b Organizimi i forumeve rajonale për identifikimin e projekt ideve për projekte kapitale për Shemën e granteve 2020

Për aplikim për mjete nga Shema e granteve për projekte investuese për vitin 2020, Qendra për zhvillim të RPJP organizoi forume rajonale për identifikimin e projekt ideve nga sfera e inkluzionit social, gjatë periudhës prej janar deri në mars 2020. Gjatë forumeve morrën pjesë 60 pjesëmarrës nga komunat, sektori joqeveritar dhe i biznesit dhe akademia. Për shkak të situatës së krijuar me COVID 19 për forumin e tretë nuk ekzistonin kushte për grupim dhe për atë shkaqe për çdo çështje Qendra komunikonte me palët e kyçura duke shfrytëzuar mjete elektronike. Nga ana e forumit u përgatitën 5 projekt koncepte, nga të cilat Komisioni për vlerësim e përzgjedhi “Rikonstruktimi dhe pajisja e qendrës moderne për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo”. Për këtë koncept u përgatit aplikacion i plotë dhe e njëjta u miratua për financim përmes Shemës së granteve për projekte investuese për vitin 2020.

2.c Organizimi i forumeve rajonale për identifikimin e projekt ideve për projekte rajonale për aplikim tek BZHR për mjete nga Programi për ZHBR për vitin 2021

Në kuadër të projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, u nënshkrua marrëveshje për përkrahje financiare të Qendrës për zhvillim të RPJP me Ministrinë e vetëqeverisjes lokale, për realizimin e Forumeve rajonale në bashkësi si mjet për identifikimin, prioritetizimin dhe përgatitjen e projekteve përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2021.

Gjatë periudhës tetor – nëntor 2020, u organizuan dy forume rajonale për identifikimin e prioriteteve dhe 9 takime në mes përfaqësuesve të komunave nga rajoni dhe ekspertëve të jashtëm. Për shkak të situatës në të cilën ndodhemi takimet u mbajtën online, përveç forumit të parë i cili u mbajt në formë të kombinuar ku një pjesë e pjesëmarrësve ishin me prani fizike dhe një pjesë online përmes platformës Zoom.

Pas fazës së parë të identifikimit të problemeve të rajonit, filloi faza e dytë për gjatjen e zgjidhjeve për të gjitha problemet e identifikuar përkatesisht u propozuan propozim projekte. Nga ana e ekspertit të jashtëm u bë grupimi i problemeve dhe zgjidhjeve të mundshme. Për secilin propozim u bë edhe cost-benefit analiza dhe si projekte më të arsyshme dhe më të levërdishme u përzgjedhën:

- Përkrahje të zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive tjera ekonomike dhe
- Efikasitet energjetik i përmirësuar në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP

Për të dy propozim projektet u përgatitën aplikime të plota dhe të njëjtat u dorëzuan deri te Byroja për zhvillim rajonal për miratim, në afatin e përcaktuar ligjor.

2.d Përgatitja e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën 2020-2024

Në periudhën prej në maj deri në gusht të vitit 2020, ekipi i Qendrës për zhvillim të RPJP, e përgatiti konceptin për përgatitjen e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2020-2024, i cili është në pajtim me Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve për zhvillim rajonal, e miratuar nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale. Gjatë muajit shtator të vitit 2020, Qendra e shpalli furnizimin publik për angazhimin e ekipit të jashtëm, me çka nënshkroi marrëveshje me d-r prof. Naume Marinovski, ekspert relevant nga fusha e zhvillimit rajonal dhe rural. Përveç atij në ekip morrën pjesë edhe katër ekspertë të jashtëm, si dhe dy përfaqësues nga Qendra.

Punëtorja e parë konsultative me palët e interesuara u organizua në datën 10 shtator në hotel Drim në Strugë. 26 pjesëmarrës nga komunat, akademia, sektori joqeveritar nga Rajoni, nga drejtuesi i ekipit, prof. Marinovski, u informuan për procesin e përgatitjes dhe miratimit të Programit për zhvillim për periudhën 2020-2024. Pjesëmarrësit u informuan edhe për rolin e tyre në përcaktimin e vizionit, qëllimeve, prioriteteve dhe masave që duhet të ndërmerren në periudhën e ardhshme programore. Në pajtim me Metodologjinë e miratuar, punëtorja e parë planifikuese u mbajt në datë 29 tetor në hotel Akualina në Ohër, me pjesëmarrje prej 23 përfaqësues të palëve të interesuara nga Rajoni. Gjatë sesionit të parë, prof. Marinovski kishte prezantim për analizat e sektorëve të bëra nga ekspertët e angazhuar për sektorët kryesorë në rajon me të dhëna statistikore, dhe drafti i SWOT&PEST analizës për sferat: ekonomia dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, arsimi dhe sfera sociale, bujqësia dhe zhvillimi rural, turizmi dhe kultura dhe ekologjia. Në sesionin e dytë, pjesëmarrësit kryen prioritetimin e faktorëve në SWOT&PEST analizën. Gjatë punëtorisë, u bë prezantimi i çështjeve gjinore nga ana e d-r Marija Ristevska, eksperte e angazhuar nga Ministria për vetëqeverisje lokale për temat të ndërlidhura me rolin e grave në shoqëri.

Qendra për zhvillim në mes të punëtorisë së dytë dhe të tretë në formë elektronike i ftoi përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm nga rajoni që t'i shqyrtojnë SWOT&PEST analizat dhe t'i përcaktojnë faktorët kryesorë, në pajtim me mendimet e tyre personale. U grumbulluan rreth 100 përgjigje nga palët e interesuara, të cilat ekspertët i shfrytëzuan për t'i përcaktuar qëllimet, prioritetet dhe masat e Programit për zhvillim të RPJP.

Punëtorja e dytë planifikuese është organizuar përmes Internet platformës në datë 1 dhjetor, me pjesëmarrje të 21 përfaqësuesve nga komunat, akademia, sektori joqeveritar dhe biznes sektori. Drejtuesi i ekipit prof. Marinovski, bashkë me koordinatorët e Qendrës për zhvillim e bënë prezantimin e draft-versionit të Programit. Të gjithë pjesëmarrësit u dakorduan që dokumenti është përgatitur në nivel të lartë me theks që Programi duhet të jetë çelësi për përgatitjen e projekteve nga ana e organizatave relevante nga Rajoni gjatë periudhës së ardhshme. Programi për zhvillim të RPJP 2020-2024 është në pajtim me përfundimet e draft-versionit të Strategjisë nacionale për zhvillim rajonal dhe dokumenteve tjera strategjike nacionale, për të cilat janë marrë edhe mendime adekuate nga tetë ministrinë lineare.

Pritet që të merret pajtueshmëri nga Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal, me çka pastaj Këshilli rajonal duhet ta miratojë këtë dokument afatmesëm.

Masa 1.1.3 Rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara për qasje deri te fondet adekuate në nivel shtetëror dhe BE

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për rritjen e kapaciteteve për qasje

Rezultatet dalëse

- U realizuan 2 furnizime publike për përgatitjen e Programit, forumeve dhe moderatorit në pajtim me rregullat e zviceranëve
 - U organizua 1 forum (i katërta) për prezantimin e rezultateve të projektit nga Shema e granteve për projekte investuese për vitin 2019 me pjesëmarrje të 25 përfaqësuesve
 - U organizuan 2 forume rajonale për identifikimin e projekt ideve për Shemën e granteve për projekte investuese për vitin 2020 me pjesëmarrje të 60 përfaqësuesve
 - U organizuan 3 takime me grupet punuese për përgatitjen e koncepteve
 - U përgatitën 5 koncepte me propozim projekte për Shemën e granteve për projekte investuese 2020
 - U përgatit një aplikacion i plotë për konceptin e përzgjedhur për Shemën e granteve 2020
 - U organizuan 2 forume rajonale për identifikimin e propozim projekteve për aplikim tek Byroja për zhvillim rajonal për mjete nga Programi për ZHBR për vitin 2021
 - U organizuan 9 mbledhje online me përfaqësues të komunave dhe ekspertëve për përgatitjen e propozim projekteve rajonale
 - U përgatitën 2 projekt aplikacione me propozim projekte rajonale për vitin 2021
 - U organizua 1 takim konsultativ për përgatitjen e Programit për zhvillim të RPJP me 26 pjesëmarrës nga rajoni
 - U organizaun 2 punëtori për përgatitjen e Programit për zhvillim të RPJP nga të cilat një me prani fizike dhe 1 Online
 - Të grumbulluara dhe analizuara 100 pyetësorë me SWOT&PEST
 - U përgatit versioni punues i Programit për zhvillim të RPJP 2020-2024 dhe u dorëzua deri te të gjithë palët e interesuara nga rajoni planor Jugperëndimor dhe deri te 8 Ministritë lineare, për shqyrtim dhe për dhënie të mendimit.

3. Biznis Qendra për përkrahje dhe shërbime të biznes sektorit

Në kuadër të aktiviteteve të Biznes qendrës pranë Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, u krye rinovimi dhe korrigjimi i data bazës ekzistuese me të dhënat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rajonale, si dhe evidentimin tek e njëjta të bujqve të regjistruar. Të dhënat janë marrë nga baza digjitale “Libri i artë”, nga njësitë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave, nga Komunitat (atje ku ekzistojnë evidencat) dhe nga baza e Odës ekonomike rajonale pranë Odës ekonomike të RMV. Në atë mënyrë, me realizimin e disa burimeve relevante kemi të dhëna të besueshme për komunikim. Të dhënat janë shpallur në UEB faqen e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor www.southwestregion.mk.

Si rezultat i anketës së realizuar janë siguruar të dhëna për nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe bujqve, dhe janë përcaktuar dy sfera tematike të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e biznesit të tyre. Në datë 13.02.2020, në hotel Drim u mbajt trajnimi i parë një ditë, ku para rreth njëzet sipërmarrësve Prof. Jovanka Biljan dha sqarime të përgjithshme për *Planifikimin e investimeve dhe përgatitjen e planit të biznesit*. Trajnimi ishte i ndarë në tri module. Në të parin u fol për përcaktimin, planifikimin e përgjithshëm dhe konkret të investimeve, ndërsa në dy të tjerat për mënyrën e përgatitjes së planit të biznesit dhe mundësitë e financimit të tij. Të pranishmit e theksuan kënaqësinë e tyre për këtë organizim dhe shprehën interes edhe për trajnime tjera.

Në pjesën e dytë të muajit aktivitetet u drejtuan kah përgatitja e trajnimit të dytë njëditor. Në datë 28.02.2020, në hotel Drim u mbajt trajnimi i dytë, në të cilin rreth njëzet pjesëmarrësve sipërmarrës, m-r Katerina Vasilevska, ju dha të dhëna të përgjithshme për *Hyrje në përgatitjen e projekteve dhe pasqyrë e mundësive të kushtuara përkrahjes së biznes sektorit*. Gjatë tre sesioneve të punës u përfshinë programet dhe institucionet vijuese për përkrahje:

1. Hyrje në BE IPA projekte ndërkufitare dhe elementet themelore/standarde të aplikacionit të projektit;
2. Ofertat e institucioneve qeveritare dhe programe për përkrahje;
3. Përkrahje nga biznesi dhe shërbime të siguruara nga sektori civil dhe privat;
4. Oferta nga bankat, kursimet dhe institucione tjera kreditore.

Në periudhën raportuese të gjithë subjekteve juridike të interesuara ju paraqitën mundësitë e financimit përmes Programit të Qeverisë së RMV për konkurrencë, sipërmarrje dhe inovacione për vitin 2020, kushtuar, para së gjithash, për nxitjen e sipërmarrjes, si dhe përmes shpalljeve të Ministrisë së ekonomisë për nxitjen e turizmit rural.

Puna e Biznes Qendrës rregullisht shpallet në FB profilin e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Në FB profilin janë publikuar rreth 200 shpallje, në nivel mujor rreth 25 shpallje. Informohet sektori i biznesit për thirrjet aktive për propozim projekte, mundësi për trajnime dhe informata tjera relevante për biznes sektorin. Gjithashtu në FB profilin shpallen edhe historitë e suksesshme të biznesit me qëllim që të motivohen edhe të tjerët të fillojnë biznesin e tyre. Rregullisht u promovuan edhe komunat e rajonit planor Jugperëndimor dhe aktivitetet e tyre, si dhe potencialet e tyre turistike.

Vendosja e bashkëpunimit me Junior Achievement JA Macedonia, me çka një pjesë e të punësuarve në Qendrën për zhvillim të RPJP morën pjesë aktive në garat e shkollave të mesme të bazuara në inovacione dhe sipërmarrësi.

Koordinatori i Biznes Qendrës gjatë muajit dhjetor morri pjesë aktive në 6 trajnime nën organizimin e FIZHT, me qëllim që të merren njohuri dhe informacione për rregullat dhe procedurat të lidhura me programet e vauçerëve dhe thirrjeve për propozim projekte.

U vendos bashkëpunim me Macedonia2025, Shoqatës së zejtarëve, Odat ekonomike dhe subjekte tjera të cilat mund të ndihmojnë në biznes sektorin në rajonin planor Jugperëndimor.

Në mënyrë elektronike, përfaqësuesit e sektorit të NVM, odat ekonomike, asociacionet dhe prodhuesit u informuan dhe u ftuan rregullisht në takimet që u organizuan nga ana e Qendrës për zhvillim të RPJP, si dhe nga institucionet e tjera në nivel nacional, rajonal dhe lokal, dhe që kishin të bëjnë me tema interesante për bashkësinë e biznesit.

Masa 1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim të sektorit të NVM

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për nxitjen e zhvillimit ekonomik në rajon

Rezultatet dalëse

- U organizuan 2 trajnime për 40 përfaqësues nga sektori i biznesit në rajonin planor Jugperëndimor
- Baza elektronike rajonale e azhurnuar e të dhënave për institucione dhe kompani që ofrojnë shërbime për zhvillimin e sektorit privat

- Zgjerimi i bazës rajonale të bujqve
- Prezantimi i mundësive për financim të biznes sektorit
- U publikuan 200 shpallje në FB profilin e Qendrës për zhvillim të RPJP
- Pjesëmarrje në 6 trajnime në organizim të FIZHT
- Vendosja e bashkëpunimit me 4 subjekte të rëndësishme për biznes sektorin
- Pjesëmarrje aktive në garat e Kampit të gjimnazistëve për inovacione dhe sipërmarrje
- Informim i rregullt i biznes sektorit në mënyrë elektronike
- U përgatitën 12 raporte mujore dhe 2 gjysmë vjetore për realizimin e aktiviteteve të projektit dhe u dorëzuan deri te MVL

4. Ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve lokale në rajonin planor Jugperëndimor

4.a Projekti- Investime në infrastrukturën lokale përmes Agjencisë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Nga fundi i muajit janar të vitit 2020 Qendra për zhvillim të RPJP me Agjencinë për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural nënshkruan marrëveshje për financim të rikonstruktimit të tri rrugëve në komunat e Strugës, Debërcës dhe Makedonski Brodit në kuadër të masës 321 për përmirësimin e kualitetit të jetës në zonat rurale, përkatësisht nën masa 321.1 Investime në infrastrukturën lokale (përfshirë urat) për lidhjen e dy ose më shumë vendbanime në zonat rurale me gjatësi prej 5 km. Me projektin, në periudhën prej muajit mars deri në korrik u bë ndërtimi, përkatësisht rikonstruktimi i këtyre rrugëve:

- Rikonstruktimi i rrugës lokale, në gjatësi prej 1450 m, për lidhjen e vendbanimeve Morovishtë-Komuna e Strugës me vendbanimin Volinë-Komuna e Debërcës. Në kuadër të aktiviteteve u kryen punë përgatitore, rregullimi bazamentit, furnizimi dhe montimi i tamponit dhe furnizimi, transporti dhe montimi i asfaltit me trashësi prej 7 cm. Punët u kryen gjatë muajit mars dhe prill, dhe prej në datën 10 prill të vitit 2020 u përfundua lidhja me asfalt e fshatrave Morovishtë dhe Volinë.

- Rikonstruktimi i rrugës lokale, me gjatësi prej 1000 m, për lidhjen e vendbanimeve Arbinovë dhe Laktinje – Komuna e Debërcës. Në kuadër të aktiviteteve u kryen edhe punët përgatitore, pastrimi me makina e asfaltit ekzistues, rregullimi gropave të hapura, transporti dhe shtruarja e asfaltit të ri me trashësi prej 6 cm, si dhe vendosja e bankinave. Punët në terren u kryen në muajin prill të vitit 2020 dhe kah fundi i muajit rruga ishte tërësisht funksionale. Me kërkesë të Komunës së Debërcës në kuadër të këtyre aktiviteteve u bë edhe rikonstruktimi i rrugës lokale në vendbanimin Arbinovë në gjatësi prej 130 m me pozita identike si edhe rruga ndërmjet dy vendbanimeve.

- Ndërtimi rrugës lokale, me gjatësi prej 896 m, për vendbanimet Tomino dhe Sushica – Komuna e Makedonski Brodit. Në kuadër të aktiviteteve u kryen edhe punët përgatitore, rregullimi i bazamentit, furnizimi, transporti dhe montimi i tamponit dhe furnizimi dhe shtruarja e asfaltit me trashësi prej 7 cm, si dhe vendosja e bankinave. Aktivitetet u kryen gjatë muajit korrik të vitit 2020 dhe kah mesi i tij muaji rruga lokale u përfundua dhe u lëshua në përdorim.

- Për nevojat e aktiviteteve të projektit u angazhua edhe Organi mbikëqyrës.

Qendra për zhvillim të RPJP të gjitha aktivitetet i përfundoi para afatit përfundimtar të marrëveshjes me APFBZHR, ndërsa nga ana e tyre kontrolli në terren u realizua kah mesi i muajit nëntor të vitit 2020.

4.b Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Komunën e Vevqanit

Komuna e Vevqanit realizoi projekt “Ndërtimi i rrugicave në komunën e Vevqanit”, me çka u ndërtuan rrugica lokale në gjatësi prej 165 m. Projekti u përkrah nga Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural me çka shuma e TVSH-së është e mbuluar nga vetë Komuna e Vevqanit.

Përmes Programit për zhvillim rural të APFBZHR u ndërtua rruga qasëse deri te tokat bujqësore Kallanoj-Unaza 1me gjatësi prej 315 m.

Masa 1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin e strukturave funksionale-hapësinore

Rezultatet dalëse

- Rikonstruktimi i rrugës Morovisht-Volinë me gjatësi prej 1450 m
- Rikonstruktimi i rrugës lokale Arbinovë-Laktinje me gjatësi prej 1000 m
- Rikonstruktimi i rrugës lokale në v.b.Arbinovë me gjatësi prej 130 m
- Përfundimi i rrugës lokale Tomino-Sushica me gjatësi prej 896 m
- Rrugicë lokale e ndërtuar në Vevqan me gjatësi prej 165 m
- U ndërtua rruga qasëse deri te tokat bujqësore në Vevqan në gjatësi prej 315 m

5. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në RPJP përmes përgatitjes së dokumentacionit teknik

Ky projekt është financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2019. Në Listën vjetore për projekte prioritare për vitin 2019 projekti u rangua në vendin e tretë, dhe për atë shkak nga shuma totale e kërkuar u miratuan vetëm 40%. Për ato shkaqe pritej që të përfundojnë procedurat e furnizimeve publike të projektit të parë dhe të dytë rajonal, që të shihet se sa mjete do të kursehen dhe të njëjtat të ridestinohen për projektin e tretë. Furnizimi publik për shërbimet e projektimit është realizuar në tetor të vitit 2019 kur me mjetet e kursyera janë siguruar 62% nga mjetet e nevojshme. Në fund të kuartalit të parë të vitit 2020 u përgatit edhe dokumentacioni teknik për rrugët vijuese: Ohër-Kisha Shën Athanasi (1460m), rruga në f.Volinë-Debërc (1000m), rrugica në f.Banjishtë-Dibër (50m), krahu i rrugës 8 Shtatori në Dibër (600m), rr.Ura e Shopit-Shtëpia e shëndetit Vevqan (650m), rruga “Turistike” në Strugë (3500m). Dokumentacioni i përgatitur përmban Projekt infrastrukturor dhe themelor me Revizion, elaborate gjeodezike, elaborate për ndikimin mbi ambientin jetësor dhe dokumente tjera përcjellëse. Projektet e lartë përmendura ju dorëzuan Komunave me qëllim që të mund t’i shfrytëzojnë për të thithur mjete për ndërtimin e infrastrukturës rrugore.

6. Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugëve dhe rrugicave lokale në Komunën e Makedonski Brod-it

Projekti është realizuar nga ana e Komunës së Makedonski Brodit me mjete financiare nga Programi për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2020 – zhvillim të fshatrave. U përgatit dokumentacion projektues për rrugët lokale f.Modrishtë-f.Vir, f.Breznicëf.Tazhevë, rrugë në f.Creshnevë, Brest dhe Suvodol. Për të gjithë rrugët dhe rrugicat janë përgatitur projekte infrastrukturorë dhe themelore, revizion të projekteve infrastrukturorë dhe themelore, elaborate gjeodezike, elaborate për ndikimin mbi ambientin jetësor.

7. Rikonstruktimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe atij të ri në RPJP

Në kuadër të projektit “Rikonstruktimi i rrjetit rrugor aktual dhe të ri në RPJP”, e miratuar nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale, përkatësisht Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2019, për shkak të çështjeve të hapura të ndërlidhura me projektin teknik për rikonstruktimin e rrugës Kosta Abrash dhe sheshit Tabana në Ohër, u vonua me realizimin e këtij aktiviteti. Punët në terren filluan në shtator të vitit 2019, dhe përfunduan në prill të vitit 2020. Me projektin u krye rikonstruktimi i rrugës Kosta Abrash dhe u ndërtua sheshi Tabana me hapësirë prej 500 m². Gjatësia e rrugës ku u intervenua është 60 m ndërsa gjerësia 3m.

Masa 1.5.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- U realizuan 2 furnizime publike
- U përgatitën projekte teknike për 6 rrugë në 5 komuna nga RPJP me gjatë totale prej 8160 m
- U përgatit dokumentacion projektues për 2 rrugë lokale dhe 3 rrugë në Makedonski Brod
- Sheshi i ri konstruktuar Tabana dhe një pjesë e rr.Kosta Abrash në Ohër me sipërfaqe prej 500 m²

8. Digjitalizimi i dokumentacionit planor-urbanistik dhe krijimi i kadastrës nëntokësore në RPJP

Gjatë vitit 2020 Qeveria e RMV Qendrës për zhvillim të RPJP i miratoi dy projekte nga të cilët njëri është “Digjitalizimi i dokumentacioni planor-urbanistik dhe krijimi i kadastrës nëntokësore në RPJP”, në të cilin partnerë ishin nëntë komunat e Rajonit. Për të dy projektet të miratuara nga ana e Byrosë për zhvillim rajonal u nënshkruan marrëveshjet për realizim gjatë muajit shkurt, me çka Qendra për zhvillim filloi me aktivitetet për implementimin e tyre. Gjatë kësaj, gjatë muajit prill, u shpall furnizimi publik dhe pritej që të përzgjidhet operatori ekonomik për kryerjen e lëndës së furnizimit publik. Para mbarimit të procedurës dhe nënshkrimit të marrëveshjes me operatorin ekonomik më të leverdishëm, nga ana e Byrosë për zhvillim rajonal deri tek Qendra për zhvillim u dërgua lajmërim për prishje të një anshme të kontratës për projektin e përmendur. Prishja e kontratës u bë pa asnjë bazë dhe për këtë janë informuar edhe ministria përkatëse dhe institucionet e tjera, por për fat të keq nuk janë marrë masa drejt BZHR, me çka Qendra humbi mjete në lartësi prej 16,2 milionë denarë.

Masa 1.5.2 Zbatimin i teknologjive informative-komunikuese

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Specifikime teknike të përgatitura për bazën e të dhënave
- Furnizimi publik i përgatitur
- U realizua furnizimi publik për shërbime për digjitalizimin e dokumentacionit planor-urbanistik dhe kadastrës nëntokësore, procedura e anuluar për shkak të prishjes së një anshme të kontratës.

Qëllimi afatmesëm 2

Arsim i përshtatur me nevojat e zhvillimit ekonomik, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore, popullatës në rajon dhe krijimi i kushteve për parandalimin e migrimit

9. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP - shkolla

Projekti është financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2019. Qëllimi themelor i projektit është zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së termoizolimit, instalimi i ri i rrymës, rikonstruktimi i pullazit. Deri në fund të vitit 2019 u përfunduan punët në të gjithë objektet përveç në SHF Shën Klimenti i Ohrit në Ohër.

Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në SHF Shën Klimenti i Ohrit – Ohër – ky aktivitet përfundoi tërësisht në prill të vitit 2020. U bë demontimi i dyerve dhe dritareve të vjetra, u furnizuan dhe montuan 109 dritare të reja me material PVC dhe 3 dritare me dyer bashkë. Gjithashtu u montuan edhe llamarinat tek dritaret në gjatësi prej 308 m, u përfunduan edhe kornizat rreth dritareve në gjatësi prej 718 m, dhe u vendosën borduret në gjatësi prej 143 m. Gjithashtu u bë adaptimi i hapësirave të kabineteve në dy klasë të reja. Me intervenimet e kryera u zvogëluar humbjet energjike, dhe janë përmirësuar kushtet e punës dhe mësimi për 475 shfrytëzues.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të lartë përmendura, komuna e Ohrit me kontributin e vetë e siguroi organin mbikëqyrës.

Masa 2.1.2 Krijimi i kushteve për hapjen e paraleleve për arsim profesional dhe institucioneve të arsimit të lartë në pajtim me nevojat e tregut të punës në tërë rajonin

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për kryerjen/rikonstruktimin e objekteve
- Hapësirat dhe gjatësitë e intervenimeve

Rezultatet dalëse

- Dokumentacioni tenderik i përgatitur, u realizua 1 furnizim publik
- U përzgjedh organi mbikëqyrës nga ana e komunës dhe kyçja në punë
- Ndërrimi i dritareve të vjetra me PVC – 109 copë dhe 3 dritare me dyer
- Montimi i llamarinës së pllafistikuar në gjatësi prej 308 m
- Vendosja e kornizave (mbështjellësve) rreth dritareve në gjatësi prej 718m
- Vendosja e bordureve në gjatësi prej 143m
- Adaptimi i 2 klasave

10. Përshtatja e objekteve me EE dhe shfrytëzimi i BRE në objektet publike - shkolla

Projekti është financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2020. Qëllimi kryesor i projektit është zvogëlimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së termo-izolimit, ndërrimit të elektrikes së re, rikonstruktimi i pullazit, rikonstruktimi i dysHEMEVE, ndërrimit të fasadës së re termike. U kryen intervenime në 7 objekte publike nga të cilat 3 janë shkolla.

Rikonstruktimi i SHF “Riste Risteski” – Dibër – në këtë objekt shkollor i cili ndodhet në f.Kosovrast janë bërë intervenimet vijuese: ndërrimi i konstruksionit të dëmtuar të pullazit me sipërfaqe prej 65,7 m²; shtruarja e pullazit me dërrasa 263 m²; vendosja e konstruksionit nga druri 577 m²; vendosja e hidroizolimit 263 m²; vendosja e termo-izolimit me lesh qelqi 240 m²; llamarinë e pllafistikuar e

vendosur 280 m²; ndërtimi i tavaneve të rinj nga gipsi 170 m²; montimi i ulluqeve vertikale dhe horizontale 59 m; kryerja e fasadës së re termike 525 m²; furnizimi dhe montimi i dritareve të reja nga PVC – 33 copë;

Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në SHF “Hristo Uzunov” – Ohër – në këtë objekt shkollor u kryen intervenimet vijuese: demontimi i dritareve të vjetra 163 copë; përgatitja dhe vendosja e dritareve të reja 13 copë; vendosja e bordurave të brendshme 42 m; vendosja e bordurave të jashtme 42 m; punimi dhe lyerja me maltor i mureve rreth dritareve dhe montimi i PVC këndeve në gjatësi prej 230m;

Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në SHF “Sande Shterjoski” – Kërçovë – në këtë objekt shkollor u kryen intervenimet vijuese: demontimi i dyerve dhe dritareve të vjetra 228 copë; përgatitja dhe montimi i dyerve dhe dritareve të reja nga PVC 228 copë; vendosja e bordurave të brendshme me gjatësi prej 320,1 m; vendosja e bordurave të jashtme 375,3 m; ndërtimi dhe lyerja me maltor i mureve në gjatësi prej 1257,8 m;

Masa 2.1.2 Krijimi i kushteve për hapjen e paraleleve për arsim të mesëm profesional dhe shkollave të mesme në pajtim me nevojat e tregut të punës në të gjithë rajonin

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim/rikonstruktiv të objekteve
- Numri i dyerve dhe dritareve të ndërruara, sipërfaqet dhe hapësirat e intervenimit

Rezultatet dalëse

- Dokumentacioni tenderik i përgatitur, u realizuan 2 furnizime publike
- U përzgjedhën organet mbikëqyrëse nga ana e komunave dhe u bë kyçja në punë
- Ndërrimi i konstruksionit të dëmtuar nga druri në pullaz 65,7 m²;
- Montimi i dërrasave në pullaz 263 m²;
- Vendosja e shtyllave të drurit 577 m²
- Vendosja e hidro-izolimit 263 m²
- Vendosja e termo-izolimit me lesh qelqi 240 m²;
- Montimi i llamarinës së plastifikuar me sipërfaqe prej 280 m²
- Ndërtimi i tavaneve të rinj nga gipsi 170 m²;
- Montimi i ulluqeve horizontale dhe vertikale 59 m;
- Ndërtimi fasadës së re termike 525 m²;
- Ndërrimi i dyerve dhe dritareve të vjetra me të reja nga PVC – 424 dyer dhe dritare
- Përpunimi dhe vendosja e kornizave rreth dritareve me gjatësi prej 1487,8 m
- Vendosja e bordurave të brendshme në gjatësi prej 362,1 m
- Vendosja e bordurave të jashtme me gjatësi prej 417,3 m

11. Realizimi i projektit investues për inkluzion social – “Rikonstruktivimi dhe pajisja e qendrës moderne për terapi fizikale në spitalin Shën Erazmo”

Qendra për zhvillim të RPJP dhe Ministria e vetëqeverisjes lokale nënshkruan marrëveshje për realizimin e projektit “Rikonstruktivimi dhe pajisja e qendrës moderne për terapi fizikale në spitalin Shën Erazmo” i cili u identifikua përmes sesioneve të forumeve rajonale. Për realizimin e të njëjtit Qendra përgatiti dokumentacion tenderik dhe përmes ESJN realizoi procedurë të hapur tre herë gjatë periudhës korrik-tetor dhe e njëjta duhet të anulohet sepse nuk kishte asnjë ofertë adekuate. Herën e katërt në nëntor furnizimi publik përfundoi me sukses dhe u përzgjedh operatori ekonomik për realizimin dhe mbikëqyrjen e objektit.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve me operatorët ekonomik u bë kyçja në punë në objekt në fund të muajit dhjetor të vitit 2020. Prej atij momenti kryerësi i punëve filloi me punët përgatitore dhe pritet që rikonstruktimi të përfundojë në fund të muajit prill të vitit 2021.

Masa 2.2.3 Ngritja e vetëdijes për barazi gjinore dhe nevoja për kyçjen e gruas në tregun e punës dhe përfaqësuesit e grupeve të rrezikuara

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin/rikonstruktimin e objekteve

Rezultatet dalëse

- U përgatitën 2 furnizime publike për ndërtimin dhe mbikëqyrjen dhe u realizuan 2 furnizime publike
- U përzgjedh kryerësi dhe organi mbikëqyrës
- U vendos në punë operatori

12. Përshtatja e objekteve me efikasitet energjetik në RPJP – kopshtet e fëmijëve

Projekti financohet përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2020. Qëllimi kryesor i projektit është zvogëlimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së termo izolimit, fasadës së re termike, rikonstruktimi i pullazit.

Kryerja e punëve për rikonstruktimin e objektit IPKF “8 Marsi” – Strugë Faza II – rikonstruktimi i objektit u krye me realizimin e aktiviteteve vijuese: ndërtimi i mureve të reja ndarëse 70 m²; lyerja e mureve të brendshme 1800 m²; rikonstruktimi i tualeteve dhe pajisja e tyre (pllaka, lavaman, WC guacka, pasqyre, bojler); montimi i pllakave 300 m²; montimi i dyerve të brendshme 23 copë; montimi i llaminatit-40 m²; lyerje me maltor të mureve të brendshme 185 m²; montimi i PVC dyerve- 4 copë;

13. Rikonstruktimi dhe adaptimi i kopshtit të fëmijëve IPKF “Planinski cvet” në Vevqan

Projektin e realizon Komuna e Vevqanit me përkrahje financiare nga Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara UNDP në kuadër të projektit “Përforsimi i këshillave komunale” me mjete nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim SDC. Me intervenimet u krye rikonstruktimi dhe adaptimi i hapësirave në kopshtin e fëmijëve “Planinski cvet”.

Masa 2.3.2 Përmirësimi i përfshirjes së fëmijëve nga moshat parashkollore në kopshtet për fëmijë, veçanërisht në mjediset rurale

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtim/rikonstruktim të objekteve
- Numri, sipërfaqja dhe gjatësia e intervenimeve

Rezultatet dalëse

- Dokumentacion tenderik i përgatitur, u realizua 1 furnizim publik
- U përzgjedh organi mbikëqyrës nga ana e komunës
- Ndërrimi i dyerve të vjetra- 23 dyer të brendshme, 4 dyer të jashtme nga PVC
- Ndërtimi i mureve ndarëse 70 m², lyerja e mureve të brendshme 1800 m²
- Rikonstruktimi i 6 tualeteve dhe pajisja e tyre
- Montimi i pllakave 300 m², montimi i llaminatit40 m²
- Lyerja e mureve të brendshme 185 m²
- Rikonstruktimi dhe adaptimi i hapësirave

14. Rinovimi dhe pajisja e Qendrës ditore për pleq dhe pensionistë në Vevqan

Projektin e realizon Komuna e Vevqanit me mbështetje financiare nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara UNDP në kuadër të projektit “Përforcimi i këshillave komunale” me mjete nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim SDC. Me aktivitetet e projektit janë rinovuar hapësirat e Qendrës ditore për personat e moshuar dhe të dobët dhe pensionistët në Vevqan. Gjithashtu u bë furnizimi i pajisjeve klimatike dhe TV për nevojat e kësaj qendre ditore me çka janë përmirësuar kushtet për qëndrim të personave të moshuar dhe të dobët dhe pensionistëve gjatë gjithë vitit.

Masa 2.3.3 Harmonizimi i programeve për mbrojtjen e personave të moshuar dhe të dobët në Rajon dhe zhvillimi i rrjetit për mbrojtje sociale në pajtim me karakteristikat demografike të Rajonit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Qendra ditore e rinovuar për personat e moshuar dhe të dobët dhe pensionistët
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve klimatike
- Furnizimi dhe montimi i televizorit

Qëllimi afatmesëm 3

Zhvillim i qëndrueshëm i llojeve selektive të turizmit të ndërlidhura me trashëgiminë kulturore dhe natyrore

15. Rregullimi i zonave dhe rrugicave atraktive në rajonin planor Jugperëndimor

Projekti financohet përmes Shemës së granteve për projekte investuese për vitin 2019, që është pjesë e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” i financuar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale. Qëllimi kryesor i projektit është të pasurohet oferta turistike përmes ndërtimit të rrugëve për këmbësorë dhe rregullimit të zonave atraktive të cilat të dërgojnë deri te lokalitetet natyrore, kulturore, arkeologjike, dhe tek vlerat turistike në zonat urbane dhe rurale, dhe me atë të rritet numri i turistëve dhe koha e bujtjeve në rajonin planor Jugperëndimor. Janë ndërtuar rrugë për këmbësorë në tri lokacione në tre komuna Ohër, Strugë dhe Debërc.

Me qëllim të zgjerimit të ofertës turistike dhe promovimit të shtigjeve të ndërtuara, u bë azhurnimi në aplikacionin Android GIS SW Macedonia Attractions. Janë shtuar të dhëna për shtigjet e reja dhe turistëve ju mundësohet që ta gjejnë rrugën dhe të shëtisin, me çka kanë mundësi të vizitojnë lokacione me trashëgimi të pasur kulturore dhe natyrore.

Masa 3.1.4 Sigurimi i informacioneve, sinjalizimit dhe vizuelizimit të atraksioneve turistike

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- Azhurnimi në Android GIS aplikacionin SW Macedonia Attractions
- Vendosja e të dhënave për rrugët për këmbësorë të ndërtuara prej Sahat Kullës deri te Porta e lartë 420 m
- Vendosja e të dhënave për rrugën për këmbësorë të ndërtuar prej Struge deri në Kalisht 1497m

- Vendosja e të dhënave për rrugën për këmbësorë të ndërtuar përreth liqenit të Sllatinës 270 m; 3 pushimore, 1 tabelë informative, 1 parking 240 m², 3 tavolina me karrige, 5 shporta për mbeturina

16. Përgatitja dhe azhurnimi i UEB faqes së re të Qendrës për zhvillim të RPJP

Me qëllim që të përmirësohet transparenca por edhe të rritet promovimi i potencialeve të rajonit planor Jugperëndimor në periudhën prej në janar deri në gusht të vitit 2020 u bë azhurnimi i rregullt i UEB faqes së Qendrës për zhvillim të RPJP www.southwestregion.mk. Në muajin shtator me përkrahje të projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” i cili financohet nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria e vetëqeverisjes lokale u bë unifikimi i UEB faqeve të tetë Qendrave për zhvillim të rajoneve planore. Në UEB faqen e re rregullisht vendosen informacionet të ndërlidhura me aktivitetet e Qendrës për zhvillim. Në faqe janë vendosur edhe të gjitha informacionet relevante të ndërlidhura me komunat nga rajoni planor Jugperëndimor, biznes sektori, sektori joqeveritar dhe institucionet arsimore.

Masa 3.3.7 Promovimi i vlerave turistike të karakterit jashtë sezonal

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- U realizuan 2 trajnime për mirëmbajtje dhe shfrytëzim të UEB faqes
- U shpallën të gjitha të dhënat relevante për 9-të komunat e Rajonit
- U përgatitën tekste dhe fotografi për aktivitetet rrjedhëse

Qëllimi afatmesëm 4

Mbrojtja e kualitetit të ambientit jetësor

17. Ndërtimi i stacionit pastrues në Vevqan

Këtë projekt e realizoi Komuna e Vevqanit me mjete nga UNDP përmes Programit për përmirësimin e menaxhimit me krahinat e mbrojtura. Përkatësisht, gjatë vitit 2019 u realizuan furnizimet publike, u nënshkrua Marrëveshja me operatorin ekonomik, dhe filloi ndërtimi i stacionit pastrues. Deri në fund të vitit 2019, 80% e punëve në stacionin pastrues janë përfunduar, ndërsa në pjesën e parë të vitit 2020 stacioni pastrues u përfundua me sukses.

17.a Rikonstruktimi i kanalizimit fekal – faza II në Vevqan

Projektin e realizoi Komuna e Vevqanit me mjete nga Programi për zhvillim të barabartë rajonal të MVL dhe BZHR për vitin 2020, përmes pjesës që i kushtohet përkrahjes së zhvillimit të fshatrave. U rikonstruktua kanalizimi fekal në rrugën Trafo-Bubanoj-Smolejca (faza 2) në gjatësi totale prej 120 m. Komuna e Vevqanit morri pjesë me mjetet e veta në vlerë prej 7% nga investimi i përgjithshëm.

Masa 4.1.3 Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese

Treguesit

- Numri i aktiviteteve

Rezultatet dalëse

- Stacion pastrues i ndërtuar
- Dokumentacion tenderik i përgatitur dhe analiza e tregut

- Furnizim publik i realizuar për furnizim të punëve
- Kanalizim fekal i rikonstruktuar në gjatësi prej 120 m

18. Projekte ideore me revizion për stacionarë për qentë endacak

Projektin “Përmirësimi i qeverisjes lokale” e koordinoi zyra e UNDP në Shkup dhe i njëjti është financuar me mjete të siguruara nga BE dhe UNDP. Specifikimi teknik, furnizimet publike dhe marrëveshja me operatorin ekonomik janë nënshkruar nga Zyra e UNDP në Shkup. Në vitin 2019 u përgatit Studimi i fizibilitetit nga ana e kompanisë amerikane NAVANTI në bashkëpunim me ekspertë të vendit. Për përgatitjen e studimit u bënë të gjitha analizat në terren, dhe është ndjekur popullimi i qenve endacak në qendrat më të mëdha urbane në rajonin planor Jugperëndimor. Me studimin është bërë analiza e gjendjes momentale dhe janë propozuar zgjidhje për këtë problem përmes propozim modeleve për menaxhim të qenve endacak. Në pajtim me studimin për rajonin planor Jugperëndimor planifikohet ndërtimi i dy stacionarëve nga të cilat 1 në Kërçovë dhe një në Ohër. Për këto dy stacionarë janë përfunduar edhe projektet ideore në fillim të vitit 2020, dhe versioni elektronik i tyre ju dorëzua komunave të Ohrit dhe Kërçovës.

Masa 4.2.1 Mbrojtja e biodiversitetit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara

Rezultatet dalëse

- U punuan 2 projekte ideore për 2 stacionarë për qentë endacak në Ohër dhe në Kërçovë
- U përgatit revizioni për 2 projektet ideore për stacionarë

19.Përshtatja e objekteve me EE dhe shfrytëzimi i BRE në objektet publike

Projekti është i financuar përmes Programeve për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal për vitin 2020. Qëllimi kryesor i projektit është zvogëlimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe për ngrohje përmes ndërrimit të dritareve, dyerve, vendosjes së hidro-izolimit, vendosjes së termo-izolimit, kryerjes së termo-fasadës, rikonstruktimit të konstruksionit të pullazit dhe mbulimi i pullazit në një objekt në rajon.

Rikonstruktimi i fasadës në Shtëpinë e kulturës – Vevqan – fasada e Shtëpisë së kulturës është rikonstruktuar tërësisht me çka janë bërë këto intervenime: pastrimi i fasadës së vjetër me sipërfaqe prej 1492 m²; demontimi dhe montimi i ulluqeve vertikale në gjatësi prej 132 m; ndërtimi i fasadës ‘demit’ me sipërfaqe prej 1171 m²; montimi i bordurave të jashtme tek dritaret me gjatësi prej 88 m.

Ndërrimi i dritareve në ndërtesën administrative në Komunën e Strugës – Me projektin janë ndërruar dritaret e vjetra prej druri në ndërtesën administrative në Komunën e Strugës me të reja nga PVC. Gjatë kësaj janë realizuar aktivitetet vijuese: demontimi i 48 dritareve të vjetra nga druri; përgatitja dhe montimi i 48 dritareve të reja nga PVC; vendosja e bordurave të brendshme në gjatësi prej 100 m; vendosja e bordurave të jashtme me gjatësi prej 100 m; ndërtimi-lyerja me maltor e mureve 340 m.

Rikonstruktimi i objektit kulturor-historik në f.Trebenishtë-faza I – Komuna e Debërcës – Me projektin u përfshi faza e parë e rikonstruktimit të objektit me intervenime në pullaz, tavane, dritaret, ujësjellësi dhe kanalizimi. Janë realizuar intervenimet vijuese: demontimi i mbulesës së pullazit 350 m²; demontimi i dyerve dhe dritareve të vjetra 44 copë; prishja e tavaneve me sipërfaqe prej 350 m²; prishja e dyshemeve 170 m²; prishja e mureve 24 m²; përgatitja e mbulesës së çimentos 230 m²; mure 62,5 m²; ndërtimi i tavaneve 268,5 m²; furnizimi dhe montimi i dërrasave për pullaz 480 m²; punimi i dyshemesë nga dërrasat në pullaz 480 m²; vendosja e shtyllave të drurit 210 m²; montimi i

qeramidheve të vjetra 130 m2 dhe qeramidhe të reja 350 m2; montimi i dritareve dhe dyerve të reja 39 copë; montimi i instalimit të ri elektrik, saniterisë dhe kanalizimit fekal.

20.Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe kontrolli energjetik për EE në objekte publike

Projekti financohet përmes Programit për ZHBR për vitin 2020 të MVL dhe BZHR. Në fillim të vitit 2020 në fazën e vlerësimit ky projekt u vlerësua pozitivisht por meqë ishte i ranguar në vend të tretë në listën prioritare nuk kishte mjete për financimin e tij dhe për atë shkak u vendos në listë si një projekt rezervë. Pas përfundimit të furnizimeve publike për projektin e parë kishte kursime në mjete financiare për të cilat u kërkua që të ridestinohen për disa aktivitete nga projekti i tretë. Në fund të muajit nëntor të vitit 2020 u nënshkrua Marrëveshje për realizimin e projektit me Byronë për zhvillim rajonal. Në kuadër të projektit janë përfshirë objekte publike në të gjithë nëntë komunat e rajonit planor Jugperëndimor dhe atë: Komuna e Ohrit – SHFK Shën Klimenti i Ohrit, Komuna e Dibrës- SHF Said Najdeni, Komuna e Vevqanit – Shtëpia e kulturës, Komuna e Makedonski Brodit – objekti i komunës, Komuna e Pllasnicës – SHFK Junus Emre f.Lisiçan, Komuna e Kërçovës – SHMK Drita dhe Mirko Mileski, Komuna e Qendër Zhupës – Shtëpia e kulutrës në f.Papradniku i Madh, Shtëpia e kulturës në f.Papradniku i Vogël, Shtëpia e fshatit në f.Broshticë dhe ndërtesa e vjetër administrative në f.Koxhaxhik, Komuna e Strugës – SHF Ashim Agushi f.Zagraçan, SHF Shën Klimenti i Ohrit në f.Morovishtë, Komuna e Debërcës – SHF Debërc në f.Trebenishtë. Në pajtim me projektin do të bëhet kontrolli energjetik dhe raporte për një sipërfaqe prej 15754 m2, dhe do të përgatitën dokumente teknike për të gjithë objektet e lartë përmendur, sipërfaqja e përgjithshme e të cilave është 16463 m2. Deri në fund të vitit 2020 u punua në përgatitjen e dokumentacionit tenderik.

Masa 4.2.2 Kualiteti i ajrit

Treguesit

- Numri i aktiviteteve të realizuara për ndërtimin/rikonstruktimin e objekteve, hapësirave, gjatësi,

Rezultatet dalëse

- U përgatit dokumentacioni tenderik për 4 furnizime, u realizuan 3 furnizime publike
- U përzgjedhën organet mbikëqyrëse nga ana e komunave dhe fillimi me punë
- Pastrimi i fasadës së vjetër 1492 m2, fasadë e re 'demit' 1171 m2, demontimi dhe montimi i ollukëve vertikal dhe horizontal 132 m2, montimi i bordureve tek dritaret 88 m
- Demontimi i mbulesës së pullazit 350 m2, 44 dyer dhe dritare të vjetra, prishja e tavaneve 350 m2, prishja e dyshemesë 170 m2, prishja e mureve 24 m2
- Punimi i shtresës së betonit 230 m2, mure 62,5 m2, tavane 268,5 m2
- Montimi i dërrasave 480 m2 në pullaz, dysheme e re me dërrasa 480 m2, shtylla druri 210 m2
- Vendosja e qeramidheve të vjetra 130 m2, dhe qeramidhe të reja 350 m2
- Vendosja e instalimit elektrik, ujësjellësit dhe kanalizimit
- Ndërrimi i dyerve dhe dritareve me të reja nga PVC – 87 dritare dhe dyer
- Përfundimi i kornizave rreth dritareve nga brenda dhe jashtë 340m
- Vendosja e bordureve nga brenda 100m, dhe jashtë 100 m

Nga shuma e të gjithë aktiviteteve nga kjo sferë konstatohet se 127 kanë qenë të ndërlidhura me realizimin e qëllimit të parë afatmesëm nga Programi për zhvillim të rajonit planor, me qëllimin e dytë afatmesëm janë ndërlidhur 58 aktivitete, me qëllimin e tretë afatmesëm 26 aktivitete, dhe me të katërtin janë të ndërlidhura 44 aktivitete nga Programi për zhvillim.

Duke i përmbledhur aktivitetet e realizuara duhet të theksohet se janë realizuar gjithsej 255 aktivitete në të kate qëllimet afatmesme nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

PASQYRË TABELARE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË VITIN 2020 DHE LIDHJA E TYRE ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktiviteteve	Numri i aktiviteteve
I.RRITJA EKONOMIKE			
PRIORITETET			
1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale	1.1.1 Lidhja e institucioneve arsimore dhe kërkimore		
	1.1.2 Rritja e kapaciteteve për inovacione të ndërmarrjeve	Punëtori konsultative, mbledhje, përgatitja e koncepteve dhe aplikacionit përfundimtar	12
	1.1.3 Rritja e kapaciteteve për fondet adekuate të shtetit dhe BE	Furnizime publike, prezantime, forume, mbledhje, koncepte, aplikacione, punëtori, takime, programe	34
	1.1.4 Mundësitë për investime në TIK		
	1.1.5 Brendimi i rajonit dhe produkteve të tija bazike		
1.2 Tërheqja e investimeve	1.2.1 Mapimi i potencialeve të rajonit për investime		
	1.2.2 Promovimi i potencialeve ekonomike		
	1.3.1 Përforcimi i kapaciteteve të NVM		
1.3 Përforcimi i sektorit të NVM	1.3.2 Mbështetje të start-up bizneseve		
	1.3.3 Shfrytëzimi i programeve për financim të NVM	Trajnime, takime pune, baza të azhurnuara, raporte, shpallje në FB, bashkëpunim	54
1.4 Bujqësia dhe zhvillimi rural	1.3.4 Lehtësime për zejjet tradicionale		
	1.3.5 Mbështetje për qasje të përbashkët të kompanive		
	1.4.1 Përmirësimi i kualitetit dhe ofertës të produkteve bujqësore		
1.5 Zhvillimi i infrastrukturës transportuese dhe komunikuese	1.4.2 Krijimi i kushteve për zhvillim rural	Rrugë dhe rrugica të ndërtuara	6
	1.5.1 Ndërtimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor	Furnizimet publike, përgatitja e projekteve themelore dhe infrastrukturore, rikonstruktimi dhe ndërtimi i rrugëve, raporte	15
	1.5.2 Zbatimi i TIK	Furnizime publike	6
			127
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktiviteteve	Numri i aktiviteteve

II.ZHVILLIM SOCIAL DHE ARSIMOR PRIORITETET 2.1 Arsim cilësor 2.2 Përfshirja në tregun e punës së grupeve të rrezikuara 2.3 Programe sociale	2.1.1 Promovimi i përparësive për AMP		
	2.1.2 Krijimi i kushteve për paralele për AMP	Furnizime publike, ndërrimi i dritareve, vendosja e izolimit, llamarinë e pastifikuar, tavane të rinj, fasadë, adaptimi i klasave	29
	2.1.3 Promovimi i biznesmenëve të suksesshëm		
	2.2.1 Iniciativa për zonat rurale		
	2.2.2 Përfshirja e kuadrit profesional në planifikim dhe		
	2.2.3 Barazia gjinore dhe përfshirja e grupeve të rrezikuara në tregun e punës	Furnizime publike, rikonstruktime	7
	2.3.1 Përfshirje më e madhe në mbrojtje sociale		
	2.3.2 Përfshirja e fëmijëve në kopshte në mjediset urbane	Furnizime publike, ndërrimi i dritareve, rikonstruktimi i tualeteve dhe hapësirave	19
	2.3.3 Programe për mbrojtjen e personave në moshë, rrjet për mbrojtje shëndetësore	Rinovim, pajisja	3
			58
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktiviteteve	Numri i aktiviteteve

III.ZHVILLIMI I TURIZMIT PRIORITETET 3.1 Zhvillimi i infrastrukturës	3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik-planor		
	3.1.2 Shtigje malore dhe rrjetëzim me rajonet e tjera		
	3.1.3 Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre		
3.2 Përforcimi i kapaciteteve për zhvillimin e turizmit	3.1.4 Info, sinjalizimi dhe vizuelizimi i atraksioneve turistike	Azhurnimi, prezantimi	5
	3.1.5 Revitalizimi dhe ndërtimi i objekteve në zonat rurale		
	3.1.6 Ndërtimi, revitalizimi i shtëpive malore		
	3.2.1 Sistem për organizim turistik të rajonit		
	3.2.2 Trajnime për ngritjen e kapaciteteve		
	3.2.3 Përmirësimi i punës së klasterëve dhe shoqatave		
	3.2.4 Vendosja e sistemit për evidentim të turistëve		
	3.2.5 Krijimi i klimës për PPP		
	3.2.6 Sistem për menaxhim me destinacionet		
	3.3.1 Azhurnimi i hartave turistike		
3.3 Krijimi i ofertës turistike rajonale	3.3.2 Brendimi i rajonit		
	3.3.3 Produkte turistike mikse		
	3.3.4 Zhvillimi i ofertës gastronomike		
	3.3.5 Produkte nga turizmi kulturor		
	3.3.6 Rritja e konkurrencës		
	3.3.7 Promovimi i vlerave turistike	Trajnime, azhurnimi, publikimi	21
Qëllimi afatmesëm	Masa	Lloji i aktiviteteve	Numri i aktiviteteve
IV. RUAJTJA E KUALITETIT TË AMBIENTIT JETËSOR PRIORITETET	4.1.1 Rikonstruktimi dhe modernizimi i sistemeve të ujësjellësit		

4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale			
4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale	4.1.2 <i>Sistem i integruar për menaxhim me mbeturinat inerte</i>		
	4.1.3 <i>Sisteme për ujëra të zeza komunale</i>	Furnizime publike, kontrata, Ndërtimi i SPUZ, kanalizime	5
4.2 Mbrojtja e biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës	4.2.1 <i>Mbrojtja e biodiversitetit</i>	Projekte ideore për stacionarë, revizione	4
	4.2.2 <i>Kualiteti i ajrit</i>	Furnizime publike, rikonstruktimi i pullazit, lyerje me maltor, ndërrimi i dritareve, termo-fasadë, instalime elektrike, ujësjellës dhe kanalizim	35
	4.2.3 <i>Mbrojtja e ujit dhe tokës</i>		
			44
GJITHSEJ AKTIVITETE TË REALIZUARA			255